



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 109, datë 19.10.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 28, DATË 05.03.2021, I NDRYSHUAR “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 458, RRUGA “BAJRAM TUSHA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, Raportit me nr. 471/54 prot., datë 17.10.2022 dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e një shtese në Aneksin 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 05.03.2021 "Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i proçesit të rindërtimit



për Pallatin nr.458, rruga “Bajram Tusha”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar.

2. Miratimin e shtesës së subjektit përfitues në Aneksin nr.1 “Subjektet përfituese pallati 458, rruga “Bajram Tusha”, sipas tabelës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, pjesë përbërëse e vendimit, si më poshtë vijon:

<b>Nr.</b>	<b>PRONARI</b>	<b>GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS</b>	<b>STRUKTURA E APARTAMENTIT, QË DO PËRFITOHET</b>
22	SUZANA HAKANI, BULJAN HAKANI, SHUSTER HAKANI, MIRSEL HAKANI	1	1+1

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 20.10.2022**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 8/8 /prot.  
 /4



Durrës, më 26.10.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
 Durrës

KRYETARIT TË BASHKISË  
 Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.109 datë 19.10.2022 :

Për miratimin e një shtese në aneksin nr 1, të VKB Nr 28 dt 05.03.2021, i ndryshuar "Për miratimin e listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr 458 Rruga "Bajram Tusha", i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019"

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative" neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" (neni 8/a) "Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore"

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI  
 EMILJAN JANI

